

PROCESVERBAL

I

KONSULTIMIT PUBLIK

PËR DHËNIE PËLQIMI NË PARIM PËR DHËNIE ME QIRA TË PASURISË NR. 2208, TË LLOJIT PYLL (SHKURRE), PJESË TË SAJ, KONKRETISHT SIPËRFAQEN PREJ 15 HA, PJESË E PASURISË NË FSHATIN KOLSH, NJËSIA ADMINISTRATIVE KOLSH, BASHKIA KUKËS. FUSHA E PËRDORIMIT TË PRONËS QË JEPET ME QIRA TË JETË: “PËR NDËRTIM TELEFERIK PASAGJERËSH OSE LINJË TË TENSIONIT, AEROGJENERATOR DHE FOTOVOLTAIKE (STACIONET, BAZAMENTET DHE OBJEKTET PËRKATËSE

Me datë 15.02.2024, ora 12:00, në ambjentet e shkollës 9-vjeçare të fshatit Kolsh, u zhvillua takimi publik , me pjesëmarrje të banorëve, kreytarëve të fshtrave, përfaqësues të njësisë administrative, anëtarë të Këshillit Bashkiak dhe Kryetarit të Bashkisë Kukës, i thirrur me “Njoftimin për konsultim publik”, Nr. 351 Prot, datë 26.01.2024.

Takimi hapet me fjalën e Kryetarit të Këshillit Bashkiak z. A.M.

z. S.H, drejtor në Drejtorinë e Administrimit të Pyjeve dhe Kullotave në Bashkinë Kukës: - Lidhur me projektaktin e shpallur për konsultim publik, arsyet, projektin dhe përfitimet e komunitetit. Kërkesa për marrjen e sipërfaqes në përdorim ka ardhur nga një subjekt privat. Ne e kemi shqyrtuar këtë kërkesë. Kemi përgatitur raportin teknik. Bashkia ka përfitimet e veta nga ky project. Edhe ju si banorë mund të përfitoni nga hapja e vendeve të reja të punës.

z. A.H: Bashkia është e hapur për çdo lloj investimi që mund të përmirësojë dhe i shërben komunitetit. Kemi shumë kërkesa dhe duhet të zhvillojmë resurset në zonën tonë. Të ardhurat që do të përfitohen janë të ardhura që do të investohen në zonën që i ka krijuar ato (me destinacion).

Banor i zonës: Kjo firmë që vjen, çfarë investimesh do të bëjë për Kolshin?

S.H; Ndarja nuk bëhet në njësi administrative por në ekonomi pyjore. Sipërfaqja më e madhe ku do të zhvillohet ky aktivitet është në Kolsh (rreth 90% e sipërfaqes). Të ardhurat që do të përfitojë bashkia, do të kthehen në investime për këtë fshat.

Z.Ll (banor): Në rast se ky investim është në interes të bashkisë, së pari duhet të ketë përfitim për ne si banorë. Duhet të dimë nëse mund të kemi dëmtime prej këtij investimi. Duhet të shihen

interest e banorëve. Ne jemi komunitet me shumë probleme (ujë, drita dhe rrugë nuk kemi). Duhet të shihen interest tona.

A.H: Ne do të kujdesemi që të ardhurat që përfitohen, t'i kthehen komunitetit të këtij fshati. Kam prioritet ujësjellësin e Kolshit, të cilin premtoj se do ta realizojmë deri në shtator të vitit të ardhshëm.

I.Ll(banor): Një kanal na është premtuar dhe nuk është bërë. Mos e harroni.

Banor Tjetër: Kolshi është i gjerë. Investimet nuk bëhen vetëm në qendër. Firmat janë duke e shfrytëzuar Kolshin Ne jemi të gjithë të papunë.

Banor tjetër: Administrata të bëjë projektin për ujësjellësin. Kemi shumë probleme. Një kanal vaditës 3 km, shkollën ku për shkak të gjendjes së mjerueshme nxënësit janë larguar (kemi më shumë mësues se nxënës), infermiera është në një godinë me qira, infermieret vijnë vetëm 1 apo 2 orë në ditë.

F.Ll(banor): Nuk jemi në kundërshtim me investimet por çfarë do të bëjnë për Kolshin. Rezervuari është i ndotur. Kanë hedhur material hekur, nikel. Duhet të pastrohet dhe të ndëshkohen firmat që shkaktojnë ndotjen.

S.H: Rehabilitimi bëhet në fund të lejes.

U.Gj(banor) : Kemi konflikt me kufinj të fshatit Kalimash. A ka rrugë për zgjidhje?

Z.Ll (banor): Komuniteti ka një problem. Në vitin 1993 kemi ndarë kufirin Kolsh-Kalimash. E kemi vendosur kufirin administrative në hartë. Hartën zyrtare me 5 vula e kam unë. Kemi bërë takim me Kalimashin. Nuk kemi rënë dakord për caktimin e kufinjve. Kërkojmë mbështetjen tuaj për zgjidhjen e problemit.

Banor tjetër: Jam nga Fushë Dukagjini. Jemi fshat i vogël. Kemi probleme me ujin, dritat, etj. Nëse investimi që do të bëni aty nuk sjell dëmtime, jemi dakord. Kanë operuar shumë firma. Ne nuk kemi parë asgjë. Nuk kemi pasur asnjë përfitim.

B.Ll: Ju lutem, kërkojmë zgjidhje për problemin e rezervuarit.

A.H: Fonde për kanalizimet dhe ujësjellësat ka shumë. Na duhen projektet.

Do përpiqemi të gjejmë zgjidhje për problemet tuaja.

Si përfundim, banorët shprehin dakordësinë për vijimin e procedurave për dhënien me qira të sipërfaqes me besimin se komuniteti do të shohë përfitime.

Kukës, datë 15.02.2024